



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.126/2017

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP)**, në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Rafet Haxhaj kryesues, Adnan Konushevcu dhe Faton Ademi anëtarë, me pjesmarrjen e zyrtarit ligjor Bajram Rexhahmetaj, duke vendosur përkitazi me ankesën e Koalicionit LDK-AKR, me seli në Prishtinë, paraqitur kundër subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje, dega në Kamenicë, për shkak të vendosjes së posterit në shtyllë publike të trafikut për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, në seancën e panelit të mbajtur me 09.06.2017, mori këtë:

### V E N D I M

**Pranohet** si e bazuar ankesa e koalicionit LDK-AKR, kështu që subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje, i shqiptohet dënimi më gjorbë në vlerë prej 1,900.00 (njëmijë e nëntëqind) euro, të cilën detyrohet ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita e marrjes-pranimit të këtij vendimi, **nën kërcënim të përmbarimit.**

### A r s y e t i m

PZAP-i, me datën 07.06.2017, ka pranuar një ankesë nga koalicioni LDK-AKR, me të cilën pretendon se me datën 07.06.2017, aktivistet e koalicionit kanë vërejtur se në Rr. “Skënderbeu” në Kamenicë është vendosur poster i kandidatit për deputet Shemsi Syla nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje. Për këtë, në kuptim të dispozitave të nenit 4.1, b, të Rregullës Zgjedhore të KQZ-së 11/2013, vendosja e postareve ose materialit tjetër i cili përdoret për qëllim të fushatës zgjedhore në shenja publike të trafikut përbënë veprim të ndaluar për subjektet politike, kandidatët dhe mbështetësit e tyre. Duke u bazuar në nenin 33 paragrafi 1 pika b) për LZP-së konsiderojmë se subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje ka shkel këtë nen në momentin që ka vendosur poster të kandidatit për deputet në hapësira publike. Në cilësinë e provës parashtruesi i ankesës i ka prezantuar PZAP-it, një fotografi nga vendi ku është vendosur poster i rastit në fjalë.

Subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje, në përgjigje në ankesë të datës 08.06.2017, thekson se me të marrë urdhërin për masat e përmirësimit nga PZAP-i, lidhur me rastin Anr.126/2017, konsideron se kanë urdhëruar që të largojë menjëher të gjitha materialet informuese për të cilat jemi njoftuar përmes shkresës suaj. Në këtë drejtim të gjitha materialet në fjalë janë larguar nga aktivistët e kësaj qendre. Për të dëshmuar këtë, përgjigjes në ankesë u janë bashkangjitur 3(tri) fotografi të printuara.

Paneli, pasi që shqyrtoj të gjitha shkresat e lëndës në kuptim të nenit 117 par.2 të LZP-së, gjeti se:

**Ankesa është e bazuar**

Paneli, nga fotografitë e ofruara si provë nga parashtruesi i ankesës, te cilat gjendet në shkresat e lëndës, në mënyrë të padyshimt, ka konstatuar se posterit i kandidatit të subjektit politik të Lëvizjes Vetëvendosje është vendosur mbi Rr. "Skënderbeu" në Kamenicë, e cila çështje nuk është mohuar as nga përgjigja në ankesë e subjektit politik LVV.

Më këtë rast, PZAP-i, vlerëson se subjekti politik i lartpërmendur ka bërë shkelje të Kodit të Mirësjelljes për subjekte politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, veprime këto që janë në kundërshtim me nenin 33 pika b) të LZP-së, e cila dispozitë ligjore përcakton: "*Veprimet e ndaluara nga ana e subjekteve politike gjatë fushatës zgjedhore që ndalon vendosjen e pllakateve, posterave dhe njoftimeve në hapsira apo në rrugë publike*"

Paneli, me rastin e vendosjes se gjobës si në dispozitiv të këtij vendimi, ka marrë parasysh rrethanat si në vijim:

- Natyra e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor;
- Shkallën dhe peshën e shkeljes;
- Nëse subjekti politik ka marrë pjesë në zgjedhjet e mëparshme, konsiderohet se kanë qenë të njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës;
- Nëse subjekti politik ka bërë shkelje të ligjeve zgjedhore në fuqi në këto zgjedhje apo në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë si dhe
- Shumën e fondeve të marra nga subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve të lidhura më fushatën zgjedhore.

Paneli, mori parasysh të gjitha rrethanat në rastin konkret ngase subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje, kanë marrë pjesë edhe në zgjedhjet e kaluara që do të thotë se janë njoftuar me rregullat zgjedhore, dhe se shkelja nga ana e këtij subjekti është përsëritur shumë herë në këtë proces zgjedhor, ku për kundër këtij fakti posterit i kandidatit për deputet nga Lëvizja Vetëvendosje, janë vendosur në shtylla në rrugë publike.

Paneli poashtu vlerësoi me rastin e vendosjes, lidhur me gjobën e shqiptuar si në dispozitiv të këtij vendimi, përpjekjet e subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje, e cili ka ndërmarrë masa përmirësuese për evitimin e shkeljes së kodit të mirësjelljes, duke i larguar posterët nga vendi që ishin të vendosur, me çka konstatohet nga fotografit e ofruar si provë që gjenden në shkresat e lëndës, të cilat masa përmirësuese kanë ndikuar në vendim-marrje, me rastin e shqiptimit të gjobës.

Andaj, duke u nisur nga arsyet e theksuara me lart, e në kuptim të nenit 32 par.2, nenit 118 par.1 dhe nenit 120 par.1 pika (c) të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia**

Anr.126/2017 më datën 09.06.2017

**Kryesuesi i Panelit**

**Rafet Haxhaj**



**Këshillë juridike:** Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4 të LZP-së